




REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Puniljeno/Prodato Received/Delivery	24.12.2021	viti god year	1
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojka Pilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHKIMSHK	6349/2021		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.999/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtar si dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.999/2021 të datës 03.12.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë rr.”Jusuf Gërvalla”, fshati Pomozotin, Komuna e Fushë Kosovës , kundër Vendimit me Nr.61/2021 të datës 02.12.2021 të Menaxherit të Personelit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 23.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.999/2021 e datës 03.12.2021 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr. 61/2021 i datës 12.11.2021 i Menaxherit të Personelit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

A r s y e t i m

Ankuesi në bazë të Akt Emërimit të datës 20.01.2012, është i punësuar në pozitën “Vozitës dhe Postier i jashtëm” në Departamentin e Administratës Qendrore në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Menaxheri i Personelit i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit me datën 12.11.2021 ka nxjerr Vendimin me numër Nr.61/2021 me të cilin ka bërë deklarin e statusit të zyrtarit publik për ankuesin duke e kategorizuar ankuesin në Nëpunës Administrativ dhe Mbështetës.

Ankuesi, i pakënaqur me Vendimin me numër Nr.61/2021 të Menaxherit të Personelit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit lidhur me deklarin e statusit të tij nga nëpunës civil me akt emërim në nëpunës administrativ dhe mbështetës, me datën 03.12.2021, fizikisht ka parashtruar ankesë me Nr.Prot:5790/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore që vendimi për deklarin të statusit të zyrtarit publik është nxjerrë në kundërshtim me Ligjin për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores Nr.10/2020 për Deklarimin e Statusit të Zyrtarit Publikë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 08.12.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ndërsa me datën 10.12.2021 kemi pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. Prot:5790/2021 të datës 03.12.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër Nr.75 të datës 30.11.2021; Vendimin me numër Nr.61/2021 të datës 12.11.2021; Akt Emërimit e ankuesit të datës 20.01.2012; Vendimin Nr. 39/2019 i datës 04.02.2019 i Komisionit të Ankesave të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 08.12.2021 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigja në ankesë e datës 10.12.2021 nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me shkresat e bashkangjitura të lëndës. Vendimin Nr.61/2021 i datës 12.11.2021 i Menaxherit të Personelit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Listën për deklaram të statusit të zyrtarit publikë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar te gjitha shkresat e lendes te parashtruara nga palët, ka konstatuar qe ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Bazuar në provat e lëndës, po ashtu edhe në dispozitat ligjore të aplikueshme në fuqi në kohën e themelimit të marrëdhënies së punës së ankuesit, nw pozitwn “Vozitës dhe Postier i Jashtëm”, respektivisht Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ankuesi nuk e ka pasur statusin e nëpunësit civil në bazë të nenit 4 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili ka përcaktuar se: **„Personeli i punësuar nga institucionet e administratës në nivel qendror dhe komunal, përgjegjës për kryerjen e funksioneve mbështetëse dhe të mirëmbajtjes, nuk janë nëpunës civilë”**, sepse marrëdhënia e tyre e punës nuk i nënshtrohet dispozitave te legjislacionit për shërbimin civil, por lidhet në pajtim me nenin 4 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: **“Marrëdhënia e tyre e punës rregullohet me Ligjin e Punës, ligje të veçanta, me marrëveshje kolektive ose me rregullore sektoriale”**.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, po ashtu ka marrë parasysh edhe Qarkoren Administrative Nr. 01/2014, datë 08.12.2014 të lëshuar nga Ministria e Administratës Publike, e cila ka definuar listën e të punësuarve në Institucionet e Republikës së Kosovës të cilët janë përjashtuar nga shërbimi civil, në bazë të nenit 4 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku nën numrin rendor 1.2 njëra prej pozitave të funksioneve mbështetëse dhe të mirëmbajtjes që është përcaktuar si pozitë që nuk është nëpunës civil, është pozita „Shpërndarës i postes ”si dhe nën numrin rendor 4 pika 1 tw kësaj qarkore njëra prej pozitave të transportit është përcaktuar si pozitë që nuk është pozite e nëpunësit civil, është pozita „Vozites ”, ne rastin konkret edhe pse ankuesi ka mbajtur akt emërim për pozitën e tij, sipas legjislacionit të lartcekur kjo pozitë nuk ka hyrë në kategorinë e pozitave të shërbimit civil.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2020 për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publikë, institucionet e administratës publike në bashkëpunim me Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, kanë qenë të obliguara që të bëjnë deklaramin e statusit të zyrtarëve publikë, siç është përcaktuar me nenin 83 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konkretisht paragrafi 5 i këtij neni, përcakton se: **“Një person, që mban një pozitë të Shërbimit Civil sipas Ligjit të Shërbimit Civil (03/L-149), e cila nuk është pozitë e Shërbimit Civil për nga funksionet dhe përgjegjësitë e saj sipas këtij ligji, do të përshtatet (rregullohet) me statusin e duhur të punësimit të përcaktuar sipas këtij ligji (punonjës i shërbimit publik, zyrtar i**



kabinetit, staf administrativ dhe mbështetës). Nëse personi refuzon të hyjë në këto marrëdhënie të tjera të punësimit, do të lirohet, sipas ligjit, nga Shërbimi Civil”.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, referuar kësaj dispozite, po ashtu referuar edhe dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me të cilën është paraparë pozita “Vozitës dhe postier i jashtëm”, konkretisht nenit 2 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *“Nëpunës administrativo-teknik- dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike”*, ka konstatuar se pozita e ankuesit me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë është kategorizuar si nëpunës administrativo teknik, andaj sipas kësaj Menaxheri i Personelit i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, duke pasur parasysh edhe listën për deklarimin e statusit të zyrtarëve publikë të dërguar nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ka nxjerr Vendimin me numër Nr.61/2021 të datës 12.11.2021 për deklarimin e statusit të zyrtarit publikë për rastin e ankuesit në pajtim me nenin 2 paragrafin 6, dhe nenin 83 paragrafin 5 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe në pajtim me nenin 5 të Rregullores (QRK) Nr.10/2020 për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publik.

Andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konststion se pretendimi ankimor i ankuesit lidhur me ndërrimin e statusit nga nëpunës civil me akt emërim në nëpunës administrativ dhe mbështetës, është i pabazuar sepse vendimi për deklarim të statusit të zyrtarit publikë është nxjerrë në pajtim me Ligjin për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2020 për Deklarimin e Statusit të Zyrtarit Publikë.

Duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë– Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A nr.999/2021

Ardita Perçuku-Shyti

Ardita Perçuku-Shyti
Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Malsore Gashi-Bajraktari
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- *Ankuesit*
- *Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit;*
- *Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*